




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, nenit 40, nenit 17 dhe 24 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-49 i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr.05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 36, paragrafi 36.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 30.05.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për rritjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për rritjen e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake të vitit 2022 dhe shpërndarjen në vitin 2023. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-193 – mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, neni 9 - të ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 1,2 dhe 6, bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave për rritjen e Buxhetit Komunal në vlerë prej **195.500.14 €** të vitit 2022 në vitin 2023.

Neni 2

Rritja e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake komunale propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike :

1. Mallëra e shërbime në shumë prej	98,404.67 €
2. Subvencione e transfere në shumë prej	50,000.00 €
3. Investime kapitale në shumë prej	47,095.47 €

Të shpërndara në këto nën programe buxhetore:

Në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime, shuma prej 98,404.67 €, në nën programet:

- Infrastruktura publike (18193), shuma prej 98,404.67 €.

Në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere, shuma prej 50,000.00 €, në nën programet:

- Zyra e Kryetarit (16033), shuma prej 50,000.00 €.

Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shuma prej 47,095.47 €, në nën-programin:

Buxhetimi (17533), shuma prej 47,095.47 €, në projektet:

- Rregullimi i fushave sportive, kodit (44152), shuma prej 47,095.47 €.

Arsyetim:

Komuna ka tejkeluar planin e të hyrave vetanake të vitit 2022 në vlerë prej 195,500.14 euro, (në vlerë prej 98,404.67 € janë rritur mallrat e shërbimet, në vlerë prej 50,000.00 € janë rritur subvencionet dhe transferet, ndërsa pjesa tjetër në vlerë prej 47,095.47 € janë rritur shpenzime kapitale).

Bartja e të hyrave në vlerë 98,404.67 € në mallra dhe shërbime bëhet për arsye të pagesës së obligimeve ndaj operatorëve ekonomik në sektorin e shërbimeve publike, bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere në vlerë 50,000.00 € bëhet për pagesën e bursave të studentëve, ndërsa bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 47,095.47 €, në projektin “Rregullimi i fushave sportive”.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Bekim Azizi

